

Crkva dhe Sapniq/Sopnić; Agimi te vendi i quajtur *Kodra e Melles/Melino Brdo*; ndërkaq Tafili në depon e Ramadan Popajt [**Bellacërkë/Bela Crkva**].

Trupi i Agimit ka mbetur në vendin e vrasjes deri më 11.10.1998, kur i vëllai Bejtullahu dhe familjarët të tjerë e varrosën në varrezat e Bellacërkës/Bela Crkva, ku prehet edhe sot.

Tafilin familjarët e kanë varrosur më 19.07.1998, në varrezat e Drenocit/Drenovac. Pas përfundimit të luftës, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Landovicë/Landovica.

Një ditë pas rënies së tij, Ganiun e kanë varrosur në fshatin e tij të Lubizhdës/Ljubizda. Pas përfundimit të luftës, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Landovicë/Landovica.

Burimet: deklarata A.K, FDH-35276; deklarata K.Z, FDH-15485; SHFDUÇK, *Feniksët...*8, 25-29, 83-87; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 131, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; Gjykata e Qarkut Prizren, K. num. 85/2005 (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.08.2006, FDH-33923; Gjykata Supreme e Kosovës, K.Z. 371/2008, (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.04.2009, 30-33, FDH-29712; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372; *Heavy Fighting Resume in Rahovec and Adjacent Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 19.07.1998, FDH-29368.

Tahir (Ramadan) Mushla

(23.06.1933, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor në fabrikën *18 Nëntori*, dy fëmijë)

Tahiri ka qenë shurdhmemec. Ai dhe bashkëshortja Zylfije i kishin dy fëmijë, Naserin dhe Sabrijen, që jetonin jashtë vendit. Tahiri punonte në *18 Nëntor* në Rahovec/Orahovac, ndërkaq kohën e lirë e kalonte në Teqenë e Qytetit. Në datën 17.07.1998, kur filluan luftimet në **Rahovec/Orahovac**, Zylfija me farefisën u larguan nga qyteti, ndërkaq Tahiri ka mbetur vetëm në shtëpi. Ditën e nesërme [**18.07.1998**], Tahiri u nis për në Teqenë. Te semafori në qendër të qytetit, e ka vlarë një serb [emri i tij është i njohur për FDH].

Dëshmitarët e ngjarjes ishin disa njerëz nga ndërtesa e afërt. Familjarët mësuan për vdekjen e Tahirit nga fundi i muajit, por nuk kanë mundur ta gjenin trupin e tij. Vetëm disa vite pas lufte, më 20.07.2004, vëllezërve të tij, Ramadanit dhe Zylfiut, u është bërë të ditur se trupi i Tahirit ishte identifikuar. Trupi i tij ishte zhvarrosur në Hoçë të Madhe/Velika Hoça. Familjarët i kanë marrë mbetjet mortore të Tahirit më 27.07.2004 dhe po atë ditë i kanë varrosur në varrezat e qytetit.

Burimet: deklarata Z.M, FDH-38028; OMPE, *Regjistri i konsoliduar...*, FDH-32367.

Baki (Sejdi) Shtavica

(18.11.1960, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, dy fëmijë)

Bakiu ka qenë punëtor në fabrikën *18 Nëntori* në Rahovec/Orahovac. Në mëngjesin e datës 19.07.1998, Bakiu me familjarët u nisën për të shprehur ngushëllime me rastin e vdekjes të së afërmit të tij, Nexhatit. Rreth orës 9:00, njësitet policore serbe, që erdhën si përforsim nga Prizreni/Prizren, u ndeshën me UÇK-në në hyrje të Rahovecit/Orahovac. Bakiu dhe të tjerë dëgjuan të shtëna të fuqishme dhe më qëllim largimin nga zona e zjarrit, u nisën drejt fshatit Xërxë/Zrze. Në fushën e quajtur *Rimnik* [**Rahovec/Orahovac**], policia hapi zjarr drejt tyre. E para u qëllua bashkëshortja e Bakiut, ndërkaq, pas pak, edhe vet ai [**19.07.1998**]. Plumbi e kishte qëlluar afër zembrës. Familjarët ia lidhën plagën. Por, rreth orës 3:00 të mëngjesit, më 20.07.1998, Bakiu ndërroi jetë. Trupi i tij i pajetë ka mbetur në fushë deri më 28.07.1998. Atë ditë, familjarët e morën trupin e Bakiut dhe e varrosën në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata Xh.B, FDH-863; deklarata S.S, FDH-32159; KKMKRF], *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Terroristički...*, III, 98, 911; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00614, FDH-35527.

Selami (Hysen) Dina

(1949, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, i pamartuar)